



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2018:044880

Datë: 14.05.2019

Numri i dokumentit: 00310967

P.nr.1238-18

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE PRIZREN DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM DIVIZIONI PENAL, gjyqtarja e vetme gjykuese Arjeta Gashi, në lëndën penale kundër të akuzuarës A.S nga, për shkak të veprës penale, kanosje nga neni 185 par.1 të KPK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prizren-Departamenti i përgjithshëm, PP/II.nr.1535-7/18 të datës 15.08.2018, në seancën e shqyrtimit gjyqësor, në prezencën e prokurorit të shtetit-Shahadin Destani, të akuzuarës, dhe të dëmtuarës A. K, me datë 13.05.2019, murr dhe publikisht shpalli, ndërsa përpiloj me date 14.05.2019 këtë:

A K T G J Y K I M

E akuzuara:

A.S, nga i ati R., dhe e ëma S., e vajzërisë A, e lindur me, në, ku edhe tani jeton, në rr. "..." nr....., më profesion juriste, e shkurorëzuar, e gjendjes së mesme ekonomike, shqiptare, shtetase e Republikës së Kosovës, me nr. personal

Konform nenit 363 par.1 nënparagrafi 1.1 të KPPK-së.

REFUZOHET AKUZA

Se me datë 02.05.2018, rreth orës 18:10, minuta, në ..., seriozisht e kanos të dëmtuarën A.K, në at mënyre që pas disa mosmarrëveshjeve të më hershme, ku e pandehura kishte pasur më ish bashkëshortin e saj, në at mënyre që e pandehura shkon ne lokalin e të dëmtuarës, dhe pas fjalosjes më ish bashkëshortin e saj, i drejtohet të dëmtuarës A. (bashkëshortë e ish burrit) me fjalët “ A e din çka ka me ta gjete fëmijën”, me ç ‘rast të e dëmtuara shkakton frikë, ankth dhe pasiguri.

- **Këso dore kishte për të kryer veprën penale kanosje nga neni 185 par. 1 të KPK-së.**

Për shkak se Prokurori Shtetit, në shqyrtimin fillestar, në mbështetje të nenit 363 par.1 nën par.1.1 të KPPK, është tërhequr nga aktakuza.

Shpenzimet e procedurës penale bien në barë të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prizren, ka parashtruar aktakuzën PP/II.nr.1535-7/18 të datës 15.08.2018 kundër të akuzuarës A. S, nga, për shkak të veprës penale, kanosje nga neni 185 par.1 të KPRK-së.

Gjykata në këtë çështje penale ka caktuar shqyrtimin fillestar, të dytë dhe shqyrtimin gjyqësorë më date 13.05.2019, në të cilin shqyrtim e dëmtuara A. K, para se të lexohet aktakuza nga ana e prokurorit të shtetit, deklaroi se tërhiqet nga propozimi për ndjekje penale kundër të akuzuarës A. S, dhe atë për shkak të veprës penale kanosje nga neni 185 par.1 të KPRK-së, me arsyetim se të njëjtit janë pajtuar nga ajo ditë nuk kanë pasur mosmarrëveshje, tani raportet i kanë rregulluar, nuk kanë asgjë të keqe në mes vete. Unë jam personi që kujdesem për dy fëmijët e këtu të pandehurës A. S, dhe kam edhe një fëmijë timin, meqenëse në mes të kësaj janë në pyetje fëmijët dhe ne si dy nëna na lidh çështja e fëmijëve tan dhe shpresoj që e njëjta nuk do të më pengoj apo shqetësoj në të ardhmen. Po ashtu shtoj se nuk parashtroj kërkesë pasuror-juridike.

E pandehura në shqyrtimin fillestar deklaroi: pasi që e dëmtuara në këtë të seancë është tërhequr nga ndjekja penale, unë i premtoj gjykatës që në të ardhmen nuk do të kenë as një shqetësim nga ana ime.

Prokurori i Shtetit në shqyrtimin gjyqësor, pas tërheqjes nga ndjekja penale e të dëmtuarës A. K, ndaj të pandehurës A. S. dhe duke marr parasysh faktin se vepra penale e kanosjes, nga neni 185 par.1 i KPRK-së, ndiqet sipas propozimit të palës e dëmtuar, i gjendur para një situatë të tillë, ka hequr dorë nga aktakuza , PP/II.nr.1535-7/18 të datës 15.08.2018, me qenë se edhe raportet në mese tyre, duket se më nuk janë të acaruar, si dhe e pandehura i premtoj të dëmtuarës që në të ardhmen nuk do ta shqetësoj më, andaj në bazë të tyre edhe është tërhequr nga ndjekja penale.

Meqenëse Prokurori i Shtetit gjatë shqyrtimit kryesor është tërhequr nga aktakuza kundër të akuzuarës, gjykata konform nenit 363 par.1 nën par.1.1 të KPPK-së, ka vendosur si në shqiptim të këtij aktgjykimi.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale është marr në kuptim të nenit 454 par.1 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës.

**GJYKATA THEMELORE PRIZREN
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM , DIVIZIONI PENAL**

2018:044880, 14.05.2019

G j y q t a r j a

Arjeta Gashi

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga koha e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.